

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

1. MATERIALE KËRKIMORE	7
2. AKTIVITETE KËRKIMORE	6
3. LINGJE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA	8

Numri 30 i materialit "Të Rejat Shkencore në Bankën e Shqipërisë" pasqyron disa nga punët kërkimore të sapo përfunduara, punët kërkimore në proces, artikujt, si dhe aktivitetet kryesore kërkimore shkencore të zhvilluara nga ekonomistët e Bankës së Shqipërisë, gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2023.

1. MATERIALE KËRKIMORE

1.1. MATERIALE KËRKIMORE TË PËRFUNDUARA

Kërkimi shkencor në Bankën e Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe, është orientuar drejt materialeve dhe analizave empirike me në fokus tema mbi gjendjen financiare të familjeve, ndryshimet dhe rreziqet e klimës, financën e gjelbër, politikën monetare, stabilitetin financiar etj. Në mënyrë të përmbledhur, ato paraqiten më poshtë.

"Dëshmi mbi brishtësinë financiare të familjeve në vendet e Ballkanit Perëndimor para COVID-19", nga Elona DUSHKU, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Duke përdorur të dhënat e nivelit të familjeve nga vala e tretë e vrojtimit Life in Transition (EBRD, 2016), ky punim përpiqet të hetojë brishtësinë financiare të familjeve në vendet e Ballkanit Perëndimor. Brishtësia financiare e familjeve është vlerësuar bazuar në aftësinë e familjeve për të përballuar një

goditje të papritur të shpenzimeve, si dhe është analizuar se si karakteristikat socio-demografike dhe ekonomike të familjeve lidhen me probabilitetin e tyre për të qenë financiarisht të brishta. Rezultatet tregojnë se pothuajse gjysma e familjeve në Ballkanin Perëndimor nuk mund të përballonin një ngjarje të papritur të shpenzimeve dhe konsiderohen financiarisht të brishta. Gjithashtu, rezultatet e marra nga regresionet probit tregojnë se përveç faktorëve socio-demografikë, zgjedhjet e portofolit të familjeve, luajnë një rol shtesë në brishtësinë financiare të familjeve.

"Rreziqet klimatike në Shqipëri dhe rëndësia e tyre për bankën qendrore", nga Margerita Topalli, Departamenti i Kërkimeve (BSH), dhe Pierre MONNIN, Ekonomist, Këshilli për Politikën Ekonomike - CEP

Ndryshimi i klimës është duke rënduar dhe do të rëndojë gjithnjë e më shumë mbi bizneset dhe familjet shqiptare. Për të zbutur

dëmin që vjen si pasojë e saj, nevojiten transformime të rëndësishme strukturore dhe investime për të pozicionuar ekonominë shqiptare në një rrugë të qëndrueshme. Për arritjen e këtij qëllimi, kërkohet përfshirja dhe koordinimi i të gjitha institucioneve private dhe publike, përfshirë Bankën e Shqipërisë (BSH). Së pari, BSH-ja duhet të përshtatë politikën e saj monetare me këtë kontekst ekonomik për të llogaritur goditjet klimatike dhe për të ofruar kushtet në mbështetje të tranzicionit. Së dyti, si mbikëqyrëse dhe rregullatore bankare, BSH-ja duhet të sigurojë që institucionet financiare të përballojnë rreziqet klimatike dhe të ofrojnë financim të përshtatshëm për ekonominë në tranzicion. Së treti, si çdo institucion tjetër financiar, BSH-ja duhet të mbajë nën kontroll rreziqet klimatike për bilancin e saj. Ky raport përshkruan sfidat që ndryshimet klimatike dhe tranzicioni i paraqesin BSH-së, si dhe opsionet e politikave që disponon banka qendrore për të llogaritur çështjet klimatike në politikën e saj monetare dhe në detyrat si mbikëqyrëse financiar. Raporti në fund ka një udhërrëfyes politikash për BSH-në për të llogaritur me shpejtësi çështjet klimatike në të gjitha aktivitetet e saj.

https://www.suerf.org/docx/f_2be3a60e8d453ec372274f39ad13c_63117_suerf.pdf

“Parashikimi i çmimeve të banesave në Shqipëri me rrjetin e të mësuarit të thellë LSTM”, nga Blerina Vika, Departamenti i Informatikës dhe Statistikës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, Ilir Vika, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Ky artikull hulumton rolin e treguesve ekonomikë, financiarë dhe demografikë në parashikimin e çmimeve të banesave në Shqipëri. Grupi i variablave është

nxjerrë nga studimet empirike për vendet e përparuara dhe ato në zhvillim. Për të testuar rëndësinë e tyre, autorët përdorin rrjetin e memories afatshkurtër të gjatë (LSTM) nga teknikat e mësimit të makinerive. Meqenëse hapësira kohore e vëzhgimeve është mjaft e kufizuar, specifikimi i modeleve është menduar të jetë i kursyer dhe i mjaftueshëm për të kapur dinamikat më të rëndësishme. Si të tilla, autorët krahasojnë performancën e një rrjeti me një variabël me modelet që përmbajnë variablat e konsideruara si më të rëndësishme, si p.sh. PBB-ja dhe qiraja, dhe më pas i zgjerojmë ato me kreditë bankare dhe normat e interesit, kërkesën nga jorzidentët, normën e papunësisë, popullsinë urbane, koston e ndërtimit dhe sipërfaqet e lejeve të ndërtimit. Aftësia e parashikimit vlerësohet gjatë periudhës 2018-2022 për horizontet në 1, 4, 8 dhe 12 tremujorët e ardhshëm. Rezultatet paraprake sugjerojnë se modelet me shumë variabla të nxitura nga teoria, mund të ndihmojnë në përmirësimin e parashikimeve të krijuara nga rrjeti një-variabëlsh. Përveç prodhimit të brendshëm bruto dhe qirave, kostot e ndërtimit dhe treguesit financiarë janë disa tregues shtesë në të cilët parashikuesit mund të kenë besim kur parashikojnë çmimet e banesave në Shqipëri.

“Ndërveprimi ndërmjet dinamikave të kreditimit dhe dobësive makro-financiare: Një analizë e thelluar e goditjeve financiare dhe implikimet për politikëbërjen”, nga Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Në dritën e zhvillimeve aktuale globale, kur ekonomitë në mbarë botën po përballen me sfidën e rritjes së inflacionit në kontekstin e shtrëngimit të kushteve financiare globale dhe dobësive të mëdha makro-financiare, monitorimi i kushteve të financimit merr

një rëndësi më të madhe në vlerësimin e procesit të transmetimit të politikës monetare dhe përcaktimin e qëndrimit të duhur të saj. Ky material kontribuon në literaturë në disa aspekte: së pari, ai prezanton një indeks të kushteve financiare për Shqipërinë, në përputhje me qasjen e FMN-së (2021), dhe shqyrton rolin e cënueshmërive në sektorin financiar, në përcaktimin e transmetimit të goditjeve financiare dhe të politikës monetare në ekonominë reale, duke kapur edhe jolinearitete në këto marrëdhënie. Disbalanca më të mëdha financiare e bëjnë ekonominë shqiptare më të prekshme ndaj goditjeve. Transmetimi i goditjeve financiare dhe i politikës monetare në ekonominë reale varet në mënyrë jolineare nga raporti i kredisë ndaj hendekut të PBB-së, që përdoret si një tregues për "dobësitë" financiare. Gjatë periudhave të cënueshmërive të ulëta financiare, një shtrengim monetar çon në një ulje të prodhimit dhe çmimeve ekonomike dhe tkurrje të kreditimit. Në të kundërtën, kur cënueshmëritë financiare janë të larta, politika monetare është më pak efektive. Këto gjetje nxjerrin në pah rëndësinë e përfshirjes së politikave makroprudenciale për të plotësuar efektivitetin e politikës monetare në menaxhimin e dobësive financiare. Konkretisht, gjetjet sugjerojnë se politikat makroprudenciale mund të luajnë një rol kritik në adresimin e dobësive të larta financiare, kur politika monetare mund të jetë më pak efektive. Prandaj, politikëbërësit duhet të marrin në konsideratë rolin bashkëplotësues të këtyre dy politikave, si asaj monetare dhe asaj makroprudenciale, për të ruajtur stabilitetin financiar.

1.2. MATERIALE KËRKIMORE NË PROCES

"SHQIPËRIA NË SHIFRA", nga Fiqiri Baholli, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Materiali synon të analizojë veprimtarinë e bankave në periudhën 1944-1990, duke e parë në kuadër të koordinimit të aktiviteteve të prodhimit dhe shërbimit, të një ekonomie plani me shumë kufizime në marrëdhëniet me jashtë. Në të është bërë një hulumtim i të dhënave për të parë, se çfarë të dhënash ekzistojnë për këtë periudhë, si dhe cilat mungojnë, dhe nëse ato mund të plotësohen.

"Inflacioni dhe ndikimi në aktivet dhe përfitueshmërinë e sistemit bankar" nga Pranvera Rrokaj, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Ky material synon të analizojë ndikimin që kanë zhvillimet e fundit ekonomike dhe financiare në sistemin bankar shqiptar. Më konkretisht, materiali synon të vlerësojë efektin e prirjeve inflacioniste në normat e interesit dhe vlerësimin e zërave të aktivitetit të bankave, si dhe praninë e faktorëve të ndjeshmërisë dhe ngjashmëritë me situatat e fundit të vështirësive në sistemet e zhvilluara bankare. Në material do të vlerësohet paaftësia paguese e bankave, faktorët që ndikojnë në përfitueshmëri dhe në likuiditet, si dhe do të kryet një krahasim me ekonominë e ngjashme. Punimi përfshin gjithashtu një analizë luhatshmërie të vlerës së zërave të aktivitetit, ndaj ndryshimeve në normat e interesit.

1.3. ARTIKUJ KËRKIMORË

“Ecuria e çmimeve për metër katror të qirave në Tiranë, dhe në zonat bregdetare e qendrore të vendit, gjatë periudhës 2017-2022”, nga Orion GARO, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Për shkak të lidhjes së ndërsjellë e të pandashme me çmimet e banesave, çmimet e qirave janë një komponent i rëndësishëm i dinamikave të tregut të pasurive të paluajtshme. Ky projekt kërkimor merr në analizë çmimet për metër katror të qirave në Tiranë, si dhe në zonat bregdetare e qendrore të vendit, gjatë 6 viteve të fundit. Objektivi i këtij artikulli është llogaritja e niveleve mesatare të këtyre çmimeve sipas vendndodhjes gjeografike dhe vëzhgimi i dinamikave të tyre në kohë. Të dhënat e përdorura për analizën dhe njehsimet e tij janë të tipit mikro, të mbledhura nëpërmjet metodës “web scrapping” dhe mjeteve zbatuese “big data”. Të dhënat tregojnë se çmimi mesatar për metër katror në Tiranë, gjatë periudhës 2017-2022, është 675 lekë, ndërsa në zonat bregdetare dhe qendrore të Shqipërisë, ky çmim është 475 lekë dhe 450 lekë. Evidentohet që çmimet e qirasë në Tiranë dhe në zonat e tjera paraqesin një trend rritës gjatë dy viteve të fundit të analizës.

“Sfidat e migrimit dhe ndryshimet demografike në Shqipëri” nga Lindita Molishti, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Në konsideratë të tendencave të fundit migratore, kjo analizë ka për qëllim ngritjen e pyetjeve mbi modelin aktual ekonomik të vendit dhe nxitjen e riformulimeve dhe këndvështrimeve që do të kërkojnë pashmangshmërisht ndryshime të rëndësishme strukturore për t'i bërë ballë

sfidës së re me të cilën përballet Shqipëria. Të dhënat e INSTAT (2021) dhe Eurostat (2021) tregojnë se popullsia shqiptare ka shënuar një rënie të mëtejshme. Artikulli paraqet tendencat e fundit migratore dhe zhvillimet demografike të popullsisë shqiptare. Janë analizuar karakteristikat e migrimit shqiptar, si dhe efektet negative që shoqërojnë këtë tendencë migrimi. Të dhënat që mbështesin arsyet e mundshme të migrimit dhe se si kanë ndryshuar këto arsye me kalimin e kohës, si dhe shtysat makroekonomike mbi këto arsye. Identifikohen disa nga sfidat e ardhshme të shterimit të kapitalit human në tregun e punës dhe nevoja e ndryshimeve strukturore për një transformim cilësor të tregut të punës për minimizimin e efekteve negative të shterimit të kapitalit human.

ARTIKUJ KËRKIMORË NGA BANKA TË TJERA QENDRORE

“Heterogjeniteti i prirjes marginale për konsum (PMK) dhe reagimi dinamik i konsumit ndaj politikës monetare” nga Miguel Ampudia, Russell Cooper, Julia Le Blanc, dhe Guozhong Zhu (BIS)

Ky punim studion sesi zgjedhjet financiare të familjeve reflektojnë në ndikimin e politikës monetare në konsum. Bazuar në të dhënat mikro nga katër vende kryesore të Eurozonës, autorët vlerësojnë parametrat strukturore për të përputhur momentet që lidhen me normat e pjesëmarrjes në treg të aktiveve, aksionet e portofolit dhe raportet e pasurisë ndaj të ardhurave sipas arsimit dhe vendit. Për shkak të heterogjenitetit në përgjigjet ndaj konsumit, politika monetare, që vepron nëpërmjet efekteve të saj në të ardhurat e familjeve dhe kthimet e tregut të aktiveve, ka një ndikim të ndryshëm

tek individët si midis tyre ashtu dhe midis vendeve. Në përgjithësi, familjet e varfra u përgjigjen më shumë variacioneve të të ardhurave të prodhuara nga inovacionet e politikës monetare, ndërsa familjet e pasura përgjigjen më shumë ndaj ndryshimeve të shkaktuara nga politika në kthimet e aksioneve. Politika monetare ka një ndikim më të madh në konsum në Itali dhe Spanjë, krahasuar me Francën dhe Gjermaninë. Zgjerimi i modelit me kanal in e pagesave të kredisë hipotekare me politikën monetare i forcon më shumë këto gjetje.

<https://www.bis.org/publ/work1102.pdf>

“A duhet të faktorizohet pabarazia në vendimet e bankës qendrore?” nga Niels-Jakob H. Hansen, Alessandro Lin dhe Rui C. Mano (Banka e Italisë)

Rritja e ndjeshme e pabarazisë në dekadat e fundit ka ndezur një debat të gjerë mbi implikimet e mundshme për politikën monetare. Ky punim përdor një model të ekuilibrit të përgjithshëm stokastik dinamik (DSGE) me agjentë heterogjenë për të vlerësuar implikimet e pabarazisë së konsumit në drejtimin e politikës monetare. Politika monetare optimale, e cila merr parasysh konsideratat rishpërndarëse, redukton pabarazinë e konsumit në një masë relativisht të vogël dhe me koston e rritjes së luhatshmërisë së hendekut të prodhimit. Anasjelltas, politikat monetare që bazohen në rregullin Taylor dhe përfshijnë një objektiv për reduktimin e pabarazisë në formulimin e tyre, mund të çojnë në një rënie të ndjeshme të pabarazisë dhe një ulje të paqëndrueshmërisë së inflacionit dhe hendekut të prodhimit.

https://www.bancaditalia.it/pubblicazioni/temi-discussione/2023/2023_1410/en/tema_1410.pdf?language_id=1

“Kalimi nga perceptimet e inflacionit në pritjet e inflacionit” nga Stefanie J. Huber, Daria Minina dhe Tobias Schmidt (Banka e Gjermanisë)

Ky material dokumenton një lidhje të fortë midis perceptimeve të familjeve për inflacionin gjatë 12 muajve të fundit dhe pritjeve afatshkurtra dhe afatgjata të familjeve për inflacionin e ardhshëm. Kjo marrëdhënie është e fortë gjatë periudhave me inflacion të lartë, por edhe më e fortë gjatë periudhave me inflacion të ulët. Rezultatet tregojnë se perceptimet e familjeve për inflacionin e kaluar drejtojnë pritshmëritë e tyre për normat e inflacionit në të ardhmen. Fuqia e kalimit nga perceptimet tek pritshmëritë ndryshon nga grupet socio-ekonomike. Dy faktorë të cilët ndikojnë në këtë heterogjenitet midis familjeve janë dallimet në pasigurinë individuale për inflacionin e ardhshëm dhe përvetësimin e informacionit. Autorët tregojnë se pjesa më e madhe e familjeve mbështeten në përvojën e tyre të blerjeve për të formuar perceptimet e tyre për inflacionin e kaluar dhe i kushtojnë vëmendje të veçantë çmimeve të ushqimeve dhe karburanteve. Përvoja e blerjeve ndikon në pritjet e inflacionit në mënyrë indirekte, nëpërmjet perceptimeve.

<https://www.bundesbank.de/resource/>

“FinTech, sofistikimi i investitorëve dhe zgjedhjet e portofolit financiar” nga Leonardo Gambacorta, Romina Gambacorta dhe Roxana Mihet (BIS)

Ky punim analizon lidhjet midis përparimeve në teknologjinë financiare, sofistikimit të

investitorëve dhe përbërjes dhe kthimeve të portofolit të tyre financiar. Autorët kanë zhvilluar një model të thjeshtë të zgjedhjes së portofolit nën informacionin asimetrik dhe kanë nxjerrë disa parashikime teorike. Duke përdorur të dhëna mikro të detajuara nga Banka e Italisë, autorët kanë testuar këto parashikime për familjet italiane gjatë periudhës 2004-2020. Rezultatet tregojnë se heterogjeniteti në përbërjen e portofolit

dhe në kthimet ndërmjet investitorëve të sofistikuar dhe jo të sofistikuar rritet me përmirësimet në teknologjinë financiare. Ky heterogjenitet reduktohet vetëm nëse teknologjia financiare është e aksesueshme për të gjithë dhe nëse investitorët kanë një kapacitet të ngjashëm për ta përdorur atë.

<https://www.bis.org/publ/work1091.htm>

2. AKTIVITETE KËRKIMORE

2.1 SEMINARI I SË PREMTES

Gjatë periudhës janar-qershor 2023 janë zhvilluar seminarët e mëposhtme:

- Seminari me temë “Ndikimi i njoftimeve nga banka qendrore në tregjet financiare”, nga Z. Michele Modugno, Kryetar i Studimeve për Stabilitetin Financiar dhe Makroekonomik, në Bordin e Guvernatorëve të Sistemit të Rezervës Federale (FED)

Materiali i prezantuar analizon elementet institucionale të provës së rezistencës së bankave në Shtetet e Bashkuara, me elementet e ndryshme të informacionit që pjesëmarrësit në treg marrin kur rezultatet e provave të rezistencës bëhen publike. Duke ekzaminuar reagimin e çmimeve të ndryshme të aktiveve, rezultatet e studimit tregojnë se pjesëmarrësit në treg vlerësojnë njoftimet nga provat e rezistencës jo vetëm për informacionin që ofrojnë në lidhje me shpërndarjet e mundshme të kapitalit në të ardhmen, por edhe si tregues të rezistencës së bankës. Gjithashtu, këto rezultate mbështesin përdorimin e testeve të stresit nga bankat qendrore për të informuar publikun e gjerë për shëndetin e sistemit bankar.

- Seminari me temë “Financa e qëndrueshme: sfidat e tanishme dhe të ardhshme”, Dr. Anjeza Kadilli, Pedagoge e financës pranë Universitetit të Gjenezës, Zvicër, maj 2023

Materiali i paraqitur kishte si qëllim prezantimin e fakteve dhe tendencave më të fundit në kuadër të investimit të qëndrueshëm bazuar në kriteret e ESG (Environmental, Social, Government) si në nivel botëror, ashtu dhe në nivel shteti, kryesisht për Zvicrën, ku padyshim një rol të veçantë në përcaktimin e investimeve të qëndrueshme luajnë rregulloret dhe të dhënat bazuar në metodologji të standardizuara. Gjithashtu, materiali paraqiti edhe ndikimet e tranzicionit aktual në ekonomi në tre drejtime kryesore si: (i) përdorimi intensiv i metaleve kundrejt energjisë, (ii) rreziku i një inflacioni më të lartë, (iii) si dhe rëndësia e inovacionit.

- Seminari me temë “Ndërgjegjësimi për ndryshimet klimatike, ndikimi dhe strategjitë e përshtatjes - Rasti i Sektorit të Bujqësisë Shqiptare” nga Z. Edvin Zhllima dhe Z. Drini Imami, Profesorë të Asociuar dhe pedagogë pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit

Ky material analizon kapacitetin adaptues dhe rrezikun nga ndryshimet klimatike në Shqipëri, bazuar në një vërtetim me ekspertë të shërbimit këshillimor publik për bujqësinë. Të anketuarit kanë identifikuar gjatë viteve të fundit rritje mbi nivelin mesatar të kohëzgjatjeve të thatësirës dhe ndryshimeve të temperaturës, shpeshtësisë së përmytjeve, reshjeve të parakohshme të shiut dhe ngricave. Gjithashtu, ekspertët pohojnë se ekziston një ndikim i lartë negativ i ndryshimeve klimatike në bujqësi, prandaj duhet të merren masa për t'u përshtatur ndaj ndryshimit të klimës në të ardhmen.

- Seminari me temë **“Ndikimi i zhvillimeve të fundit në sektorin e ndërtimit dhe tregut të pasurive të paluajtshme: Të dhëna rreth tendencave të çmimeve dhe impaktit ekonomik e social”**, nga Z. Enkelejd Musabelliu, Kompania Adriatica RC

Materiali i prezantuar përpiqet të bëjë një përshkrim të zhvillimeve më të fundit mbi sektorin e ndërtimit dhe tregun e pasurive të paluajtshme. Gjithashtu, studimi përpiqet t'i japë përgjigje pyetjeve si: Sa efektive janë programet ekzistuese të strehimit dhe planet komunale të banimit? Si dhe cilat janë pasojat e mundshme nga zbatimi i taksës së re në pronë?

2.2 PJESËMARRJA NË AKTIVITETE TË TJERA

- Prezantimi i materialit me temë **“Brishtësia financiare e familjeve në vendet e Ballkanit Perëndimorë para COVID-19”**, nga Elona Dushku, Departamenti i Kërkimeve, në Workshop-in e II-të mbi Ekonominë Krahasuese të Evropës Juglindore: Investimi në Infrastrukturën Ekonomike dhe Sociale, zhvilluar nga LSE (London

School of Economics) në bashkëpunim me Universitetin e Beogradit, më 30-31 mars 2023.

Bazuar në të dhënat e valës së tretë të vërtimit Life in Transition (EBRD, 2016), materiali evidenton se pothuajse gjysma e familjeve në Ballkanin Perëndimor është e paaftë financiarisht për të përballuar një shpenzim të papritur. Rezultatet tregojnë që probabiliteti i familjeve për të qenë të dobët financiarisht është i korreluar negativisht me nivelin e të ardhurave, edukimin, përfshirjen financiare dhe të pasurisë pasuri të patundshme.

- Prezantimi i materialit me temë **“Vlerësimi i efekteve të ndryshimeve demografike në ekonominë shqiptare”**, nga Meri Papavangjeli, Departamenti i Kërkimeve, në një takim virtual me përfaqësues të Bankës së Kolumbisë, në kuadër të programit të BCC-së (Bilateral Assistance and Capacity Building for Central Bank), si pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit të Bankës së Shqipërisë me Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO)

Materiali bazuar në modelin e Gertler-it me tregues demografikë të ndryshueshëm në kohë, si dhe me rritje konstante të produktivitetit dhe treguesve fiskalë, paraqet vlerësime mbi masën e ndikimit të ndryshimeve demografike në ekonominë shqiptare në normat reale të interesit, si dhe të treguesve të tjerë makroekonomikë. Simulimet e bëra për ekonominë shqiptare gjatë një horizonti kohor 20-vjeçar dhe 100-vjeçar, duke përdorur projeksionet e OKB-së për tregues të caktuar demografikë, paraqesin ndikimin që këto ndryshime kanë pasur si në normën ekuilibër të interesit, ashtu dhe në tregues të tjerë makroekonomikë.

2.3 THIRRJE PËR PJESMARRJE NË WORKSHOPIN XVII TË KËRKIMEVE EKONOMIKE TË EVROPËS JUGLINDORE

Në datat 4 dhe 5 dhjetor 2023, Banka e Shqipërisë do të organizojë në Tiranë Workshop-it XVII të Kërkimeve Ekonomike të Evropës Juglindore. Ky workshop synon të ofrojë një forum diskutimi të punëve kërkimore mbi çështje të lidhura me bankën qendrore dhe të nxisë shkëmbimin e pikëpamjeve midis kërkuesve të Bankës së Shqipërisë, të bankave qendrore të rajonit e më gjerë, si edhe të institucioneve financiare e akademike vendase dhe të huaja.

Autorët e interesuar janë të ftuar të marrin pjesë me punimet e tyre kërkimore, duke dorëzuar një abstrakt të zgjeruar ose studimin e plotë, brenda datës 2 tetor 2023, në adresën: BoAresearchworkshop@bankofalbania.org. Për detaje të mëtejshme referojuni më poshtë: "Thirrjes për aplikime në workshop-in XVII të Kërkimeve Ekonomike të Evropës Juglindore" (në anglisht).

https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Thirrje_per_aplikime_Workshop-i_XVII_i_Kerkimeve_Ekonomike_te_Evropes_Juglindore_Tirane_4-5_dhjetor_2023.html

3.LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA:

Banca d'Italia

<http://www.bancaditalia.it/studiricerche/>

Bank of Canada

<http://www.bankofcanada.ca/research/>

Banco de Espana

<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>

Bank of England

<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>

Bank of Finland

http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm

Bank of Greece

<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>

BIS Central Bank Research Hub

<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>

Czech National Bank

<http://www.cnb.cz/en/research/>

Deutsche Bundesbank

http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php

European Central Bank

<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>

Federal Reserve

<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>

International Journal of Central Banking

<http://www.ijcb.org/>

National Bureau of Economic Research

<http://www.nber.org/>

International Monetary Fund

<http://www.imf.org/external/pubind.htm>

Oesterreichische Nationalbank

http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp